



Informacion

Aktivitetet e Zhvilluara gjatë vitit 2008,
nga
Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë

Organet Drejtuese

të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë:

1. **Kongresi**
2. **Konferenca**
3. **Këshilli Drejtues**
4. **Kryesia**

Drejtuesit e Zgjedhur

të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë:

1. **President,** dr. Minella Mano-Menaxhim, Planifikim Shëndetësor
2. **zv. President,** dr. Erion Dobi-Onkolog
3. **zv. President,** dr. Benereta Hoxha-Nefrologe

1. Takime/biseda me Këshilla dhe Seksione Sindikale

Gjatë kësaj periudhe kemi punuar për disa ligje të reja dhe V.K.M, si Fondi për Institutin e Sigurimeve Shëndetësore, etj.

.....

2. Organizime, Riorganizime, të Strukturave

-F.S.SH.SH-ja është përfshirë në një proces domethënës reformash, më qëllim në veçanti konsolidimin e strukturave të saj profesionale, për të bërë të mundur që ato të zhvillojnë aktivitetin e tyre konkret dhe cilësor, si në sektorët e shërbimeve publike, ashtu edhe në ato private, për të

organizuar dhe përfaqësuar punëtorët-të punësuarit e të niveleve të shërbimit.

-Ne si Federatë kemi vlerësuar zhvillimet tona dhe përgjithësisht të lëvizjes sindikale dhe bazuar në kërkesat e nevojat, kemi tërhequr mendimet dhe kërkesat, si dhe kemi realizuar studimet përkatëse, nëpërmjet disa projekteve, që kemi aplikuar (në P.S.I, në Fondacionin Friedrich Ebert Stiftung (F.E.S), etj, dhe të tjera, për të cilat presim përgjigjet.

-Rrjeti i Rinisë mbështetet nga një **Departament i Rinisë** që ka buxhetin e tij. Objektivi kryesor është dhe ngelet, zgjerimi i punës së **F.S.SH.SH**-së drejt të rinjve, **për të ofruar dhe mobilizuar të rinjtë pranë strukturave të sindikatës tonë**, që vetë ata-ato të jenë më të informuar rreth Sindikatave, rreth Federatës së Shëndetësisë, historisë së saj, strukturave, pluralizmit, profesionalizmit, aktiviteteve të kryera në vite, realizimeve konkrete, statutit dhe demokracisë së brendshme, partneritetit institucional, dhe gjithçkaje tjetër që mundëson njohjen më të mirë të të gjitha strukturave dhe vizionit të saj Institucional.

-Disa prej Seksioneve të Federatës, kanë menduar dhe investuar pak dhe shumë pak dhe **nuk i janë përkushtuar kësaj detyre**. Gjithsesi vlen të themi se, gjenden në fillim dhe se mund të quhet **objektiv jo i kryer**, kjo edhe për pamjaftueshmëri angazhimi serioz nga njerëzit e përzgjedhur/e caktuar nga institucionet dhe strukturat përkatëse.

-Më pak nga Seksionet e Federatës është punuar për rininë/të rinjtë, ndonëse dihet që është kjo pjesë e shoqërisë ajo që gjendet në vështirësi të mëdha studimi, punësimi, edukimi, kualifikimi, integrimi dhe sigurimi të jetesës.

-Rrjeti i Gruas së F.S.SH.SH-së, ka ende shumë punë për të realizuar që **kjo strukturë të veprojë e pavarur dhe të marrë përgjegjësi të konkrete**. Kjo strukturë për të ardhmen, duhet të synojë të rrisë kapacitetet dhe njohuritë profesionale, për të promovuar barazinë gjinore, për të luftuar diskriminimin, dhunimin, për të fituar të drejtat dhe të forcojë pozitën e grave-femrave, për të marrë pjesë në përgjegjësitë profesionale dhe ato sindikale.

-Është punuar më mirë **për edukimin** e tyre, nisur edhe nga disa eksperiencia, **projekte**, të realizuara në bashkëpunim dhe në bashkëfinancim

me sindikata të tjera dhe me Institucione të ndryshme Ndërkombëtare dhe të vendit.

-Prej këtyre projekteve, **më shumë kanë përfituar të rejtat, studente të Fakulteteve të Mjekësisë dhe të Infermierisë**, gjithsesi ngelet shumë punë për të kryer me të rejtat e punësuar, sidomos me **Infermieret** të cilat nisur edhe **nga numri i tyre përbëjnë shumicën**, por edhe **Mjeket e Personeli tjetër ndihmues femra**, të këtij shërbimi janë në numur të konsiderueshëm.

3. Anëtarësi të reja

-Gjatë këtij viti është punuar për rritjen e numrit të anëtarëve të rinj, pra shtimit të numrit në strukturat tona, në këshillat sindikale, pranë Institucioneve Punëmarrëse, si në Spitalet ashtu edhe në Qendrat Shëndetësore, ku është biseduar si me Mjekët e Përgjithshëm/të Familjes, ashtu edhe me Mjekët Specialistë, sikurse me Infermieret, Sanitaret, Laborantet, Teknikët dhe të gjithë të punësuarit e tjerë që ofrojnë këtë shërbim ndaj të sëmurëve dhe njerëzve në nevojë, që kërkojnë kujdes dhe mbrojtje të shëndetit të tyre.

-Nisur nga situatat konkrete, vlen të theksojmë se kanë munguar takimet në disa Qarqe dhe Institucione, kjo për disa arsye, si të mungesës së burimeve njerëzore (aktualisht në federatë ka vetëm një të punësuar, vetëm presidenti i zgjedhur i saj), ashtu edhe të atyre financiare (mungesa e derdhjes të kontributeve individuale të vetë anëtarëve, pra mosderdhjes së kuotave, bazuar në statutin konkret).

-Duhet thënë se edhe prej niveleve të zgjedhura, pra, të të zgjedhurve, kryetarëve në nivelin e Seksioneve dhe të Këshillave Sindikale, të Institucioneve në Qarqet përkatëse ka munguar interesimi serioz dhe përgjegjësia qytetare, për t'iu përgjigjur detyrave dhe grupimit profesional, mosaktivizim ky i cili ka dëmtuar punën dhe opinionin ndaj tyre dhe grupimit që ata dhe ato përfaqësojnë.

-Ka një indiferencë nga Kryetarët e përzgjedhur, e paguar, por dhe nga Këshillat e Konfederatës në Qarqe, mungesë aktivizimi kjo që ka dëmtuar si lidhjen midis strukturave statutore, por edhe një ftohje negative midis kolegësh, që shpesh duket si përjashtim, si mosdëshirë, si paaftësi, si inat, si pamundësi, si qëllim i keq dhe mungesë respekti ndaj Drejtuesve dhe strukturave të një Federate të caktuar dhe konkretisht kjo vlen edhe për

qëndrimin ndaj Federatës së Shëndetësisë, duke dëmtuar funksionimin dhe statusin tonë financiar, brenda grupimit në Konfederatë.

-Në ato Seksione ky është punuar prej të zgjedhurve është mundur që të ruhet numri i anëtarësisë, si dhe të rritet numri nëpërmjet anëtarësimeve të reja, por ky numër ka qënë i vogël dhe me shtrirje jo të gjerë në Institucionet dhe Qarqet e ndryshme të vendit.

-Gjatë këtij viti **janë ngritur disa Këshilla Sindikale** nga ku janë anëtarësuar:

Në Qendrën Shëndetësore **Pogradec**, janë anëtarësuar **17** punonjës, në Spitalin Berat janë anëtarësuar **70** punonjës, në Qendrën Shëndetësore **Patos- Fier** janë anëtarësuar **15** punonjës, në Qendrën Shëndetësore **Cakran-Fier** janë anëtarësuar **23** punonjës, në Institutin e Shëndetit Publik, **Tiranë** janë anëtarësuar **49** punonjës, në Shërbimin Onkologjik në banesë, **Tiranë** janë anëtarësuar **13** punonjës, në Qendrën Shëndetësore **Shkozë-Tiranë**, janë anëtarësuar **20** punonjës, në Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, **Tiranë** janë anëtarësuar **34** punonjës, **Gjithsej 251 anëtarë**, sikurse po punohet në të tjera institucione, si në Tiranë (në Fakultetin e Mjekësisë, në Fakultetin e Infermierisë), në Durrës, në Gramsh, në Elbasan, në Lushnje, etj. Vlen të themi se ende në disa Qarqe mungon puna konkrete dhe për pasojë anëtarësimet kanë munguar.

4. Kuotat e anëtarëve

-Gjatë këtij viti, nuk ka zhvillime të mira lidhur me nivelin e kuotave të drdhura për Federatën e Shëndetësisë, ndonëse janë ofruar disa zgjidhje të mira për anëtarët dhe jo anëtarët, punonjës të Shërbimit Parësor, ambulator, të administratës të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (Mjeku i familjes, Infermierët dhe Mjekët specialistë të shërbimit parësor, ambulator), si dhe për Shërbimin sekondar, Spitalor, kuderdhja e kuotave prej të anëtarësuarve është parashikuar edhe në Kontratat Kolektive të Punës të nënshkruara nga palët, Punëdhënës e Punëmarrës.

-Kjo ka ndodhur sepse prej të zgjedhurve të Seksioneve dhe Këshillave Sindikale të Federatës në Institucionet e Qarqeve, nuk është ushtruar funksioni juridik dhe nuk janë ndjekur për zbatim të gjitha nenet e Kontratave, sidomos ai nen i cili ka të bëjë konkretisht me derdhjen e kuotave të anëtarësisë, në numrin e llogarisë të Federatës së Shëndetësisë.

-Gjithashtu prej Kryetarëve të K.S.të Konfederatës në Qarqet përkatëse, ka munguar si interesimi konkret ashtu edhe moskuptimi i detyrave të veçanta, ashtu edhe atyre të përbashkëta, të strukturave tona, si një grupim Konfederativ, ku duhet të funksionojë si fryma e grupit, e ndihmës dhe e koordinimit të punëve, bazuar në nevojat dhe në qëllimet, në detyrat tona.

-Edhe pengimi që i kanë bërë Drejtues të këtyre Institucioneve Shëndetësore, por edhe individë të tjerë individë të pushtetshëm, njerëz të lidhur politikisht dhe fanatikë të partive politike, apo koalicioneve në Qeverisje, kanë dëmtuar në vazhdimësi dhe rëndë financat e Federatës dhe edukimin e anëtarësisë, për të kuptuar se anëtarësia nënkupton detyrimin edhe financiar ndaj grupimit profesional, ku ke/ka dëshiruar të anëtarësohesh/het dhe të kontribuosh/ojë, për të përfituar mbrojtje dhe të drejta të nevojshme, të domosdoshme, të cilat në forma dhe mjete të ndryshme të pengohen të realizosh e më pas të përfitosh, derdhjen e kuotave të anëtarëve, kuota të cilat së bashku si numur na mundësojnë një sigurim më të mirë ndaj vetë individëve kontribues, pra anëtarëve të grupimit profesional.

-Kanë dëmtuar edhe veprimet e qëllimshme, keqdashëse, të shumë drejtuesve të ndryshëm nëpër Spitalet, Qendrat Shëndetësore dhe Institucionet e tjera Studimore e Shkencore, të cilët ndonëse njohin, apo pak njohin, konkretisht partnerët sindikalë, pra dinë cila është sindikata më përfaqësuese në Institucionin e tyre, bazuar në Konventat Ndërkombëtare, në Kriteret dhe në Kodin e Punës të vendit, janë vënë në shërbim të pushteteve, të individëve dhe të strukturave politike-sindikale, duke përkrahur padrejtësisht dhe jo drejtësisht, pra antiligjërisht dhe antidemokratikisht atë sindikatë dhe grupim sindikal, në fakt josindikal, atë “Drejtues/Lider” të njohur apo mik të miqve të tij politikë, të “idealeve”, dhe që ndonëse i mungojnë kriteret përfaqësuese dhe profesionale, veprojnë negativisht, vetëm për të goditur njërin që se duan, që atyre s’ju duhet dhe për të ngritur tjetrën, atë që mendojnë se do t’ju duhet, duke u shitur apo duke i shërbyer atij që i drejton, atij prej të cilit është vendosur në detyrë, është ngritur në përgjegjësi, atij që i urdhëron dhe i udhëzon, se si duhet të veprojnë dhe kë të ndihmojnë.

-Janë derdhur në nr. e llogarisë të Federatës së Shëndetësisë dhe me mandat arkëtimi, Gjithsej për vitin 2008, 714. 200 lekë (ku 130.000 janë të mbartura).

-Kjo shumë kuotash/financash është e pamjaftueshme për të mbuluar normalisht të gjithë aktivitetin e përditshëm dhe objektivat e planifikuara, për ti zhvilluar në kohë dhe me cilësi të gjitha aktivitetet dhe projektet konkrete, pa menduar për zhvillime më të shpejta dhe për zgjerim të domosdoshëm të aktiviteteve sindikale dhe sidomos me vizionin e drejtuesve për Federatën dhe anëtarët e saj kontribues.

-Vlen të theksohet se nga disa ndryshime të bëra, me propozim të Konfederatës, gjatë këtij viti, lidhur me financimet, me përqindjet, mbajtjet dhe ndarjet e shumës së kuotave të derdhura nga anëtarët e Federatës së Shëndetësisë, është prekur pavarësia juridike e Statutit të Federatës së Shëndetësisë, si dhe është nxitur konflikti midis strukturave brenda saj, por sidomos midis Këshillave Sindikale të Konfederatës, Kryetarëve dhe Federatës, duke çrregulluar këtë proces dhe dëmtuar grumbullimin e menaxhimin sa më të mirë të tyre, nga struktura statutore.

-Duhet të pranohet se edhe nga vetë të zgjedhurit e strukturave të Seksioneve, të Këshillave Sindikale dhe anëtarët konkretë të Federatës së Shëndetësisë, ka një indiferencë dhe mungesë kontributi lidhur me pagimin e kuotave sipas nenit përkatës në Statutin e Federatës, duke dëmtuar seriozisht, konceptin se një anëtar duhet të paguajë kuotën për grupimin ku bën pjesë, por kryesisht burimet financiare, që siç dihet përbëjnë burimin e vetëm, me të cilat kjo strukturë dhe të zgjedhurit e saj duhet që të funksionojnë, në interes të detyrave, të aktiviteteve për të cilat është krijuar, pra, rezikohet mbrojtja e vetë të drejtave të vetë anëtarëve, të të punësuarve, të institucioneve dhe të vetë shërbimit, duke rrezikuar funksionimi, pavarësinë dhe garantimin e vazhdimësisë të këtij grupimi profesional.

5.Kërkesa për zgjidhje

Mbas njohjes së situatës konkrete, në vazhdimësi dhe me kujdes, në këtë sektor për gjendjen e të punësuarve, anëtarë apo jo anëtarë të sindikatës/federatës, mbas njohjes të situatës konkrete të vetë sistemit të përkujdesjes shëndetësore, të institucioneve dhe infrastrukturës në përdorim, të masës dhe formave të financimeve dhe investimeve, të kontraktimit kolektiv dhe individual, të funksionimit ose jo të partneritetit, midis punëdhënësve dhe punëmarrësve, të decentralizimeve, apo jo, të menaxhimeve, të cilësisë dhe të standardeve që këto institucione dhe të punësuar, specialistë dhe profesionistë ofrojnë, si dhe të njohjes të gjendjes në të cilën ndodhen të sëmurët/pacientët, gjatë vuajtjes nga ndonjë

shqetësim apo sëmundje, por edhe të sigurimit të të drejtave njerëzore, të garantimit apo jo të lirisë të organizimit në sindikata, të atyre njerëzve që dëshirojnë të organizohen dhe të kontribuojnë, të masës të pagimit, të shpërblimit dhe të respektimit e të motivimit të të punësuarve, kemi listuar dhe për zgjedhur kërkesat, që më pas ia kemi drejtuar ato të gjitha Institucioneve Punëdhënëse, Qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, si dhe Drejtorive dhe strukturave të tjera përgjegjëse, për të krijuar mundësinë e bisedimeve, në interes të Dialogut Social dhe të zgjidhjeve konkrete.

6.Partneriteti- Kontratat Kolektive dhe Individuale të Punës

-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, përfaqësohet prej Presidentit të saj, dr.Minella Mano, në Këshillin Administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, si anëtar, dhe n/Kryetar i saj, duke paraqitur kërkesat dhe mbrojtur interesat, si të të punësuarve, anëtarë ose jo anëtarë të Federatës së Shëndetësisë, ashtu edhe të grupimeve të ndryshme dhe njerëzve të sëmurëve në nevojë, të paafteve dhe invalidëve, të pensionistëve dhe të vetë sistemit shëndetësor.

-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, përfaqësohet prej Presidentit të saj, dr.Minella Mano, në Këshillin Kombëtar të Punës, si anëtar i saj, duke mbrojtur interesat si të Federatës së Shëndetësisë, ashtu edhe të Federatave të Profesioneve të tjera, anëtare të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, por edhe të shtresave të tjera të popullatës.

-Gjatë këtij viti bazuar në Dialogun Social dhe Partneritetin, nga nënshkrimi edhe i Kontratës Kolektive të Punës, midis Punëdhënësit, firmosur nga Drejtore e Përgjithshme znj. Elvana Hana dhe Punëmarrësit, firmosur nga President z.Minella Mano, kemi mundur të sigurojmë një mjedis pune/një Zyrë, në ndërtesën e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, në Tiranë.

-Janë realizuar takime me të zgjedhur dhe anëtarë të Federatës së Shëndetësisë për të biseduar rreth Kontratave Individuale të Punës, sikurse është biseduar me drejtuesit e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, si Institucioni Punëdhënës dhe Partner për realizimin e këtyre Kontratave, duke sugjeruar vërejtjet dhe propozimet tona si Sindikatë, kontrata të cilat do të nënshkruhen prej të gjithë Mjekëve të

Familjes, të Punësuar në Shërbimin Parësor, gjatë Muajit Janar 2009, me afat kohor 1-vjeçar.

-Janë **1622 Mjekë, të Shërbimit Parësor/Ambulator**, që përfitojnë nga këto Kontrata, sikurse janë të kontraktuar/të mbrojtur me Kontrata Individuale Pune edhe të gjithë të punësuarit e profesioneve të tjera, të ndryshme të **Administratës të I.S.K.Shëndetësor**, në të gjitha Drejtoritë, si: në **Drejtorinë e Përgjithshme të I.S.K.Sh-së**, në **Tiranë**, Gjithsej **123** punonjës, në **Drejtorinë Rajonale të Tiranës 80**, të **Vlorës 22**, të **Shkodrës 22**, të **Lezhës 23**, të **Kukësit 25**, të **Beratit 25**, të **Peshkopisë 21**, të **Durrësit 34**, të **Elbasanit 27**, të **Fierit 28**, të **Gjirokastrës 21**, të **Korçës 33**, **Gjithsej, 484 punonjës, në nivel Kombëtar.**

-Për realizimin e këtyre Kontratave Individuale, kemi mbajtur në konsideratë ato çka kemi të shkruara dhe të përfituara nga **Kontrata Kolektive e Punës**, e nënshkruar nga palët juridike, Punëdhënës, **I.S.K.Sh-ja**, Drejtore e Përgjithshme znj, Elvana **Hana** dhe **F.S.SH.Sh-së**, President z.Minella **Mano**, firmosur dt. **05/06/2006**, me **afat 3-vjeçar**, afat i cili është në përfundim dhe për të cilën po punojmë që ta nënshkruajmë para përfundimit të afatit.

-Kjo Kontratë Kolektive Pune, mbron **Gjithsej 9128**, punjonjës, ku prej tyre janë: **1622 Mjekë të Përgjithshëm/të Familjes**, **304 Mjekë Specialistë**, **6591 Infermiere** dhe **611 Staf ndihmës**, të punësuar në Institucionet e Shërbimeve Shëndetësore, në nivel kombëtar.

-Është nënshkruar nga palët juridike, me Punëdhënësin, M.Sh-së, **Ministrin** z. Maksim **Cikuli** dhe **F.S.SH.Sh-së**, **Presidentin** z. Minella **Mano**, firmosur dt. **08/12/2006**, me **afat 3-vjeçar**, afat i cili përfundon në fund të vitit në vazhdim, ku duhet të punojmë që ta nënshkruajmë atë në kohën e duhur, me një cilësi më të mirë.

-Kjo Kontratë Kolektive Pune, mbron **Gjithsej**, punjonjës, ku prej tyre janë: **..... Mjekë të Përgjithshëm/të Familjes**, **..... Mjekë Specialistë**, **..... Infermiere** dhe **..... Staf ndihmës**, të punësuar në Institucionet e Shërbimeve Shëndetësore, në nivel kombëtar.

-Mbas disa takimesh më dt. **27/10/2008**, është **nënshkruar Kontrata Kolektive e Punës**, me **afat 2-vjeçar**, midis Punëdhënësit, **Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës**, përfaqësuar nga **Drejtori Ekzekutiv z.**

Mëhill Gecaj dhe Punëmarrësit, Presidentit të **F.S.SH.Shqipërisë** z.Minella **Mano**.

-Kjo Kontratë Kolektive Pune, mbron **Gjithsej**, punjonjës, ku prej tyre janë: **Mjekë të Përgjithshëm/të Familjes**, **Mjekë Specialistë**, **Infermiere** dhe **Staf ndihmës**, të punësuar në Institucionet e Shërbimit Shëndetësor Parësor, të Tiranës.

-Është nënshkruar më dt. / /2008, **Kontrata Kolektive e Punës**, me afat **2-vjeçar**, midis Punëdhënësit, **Institutit të Shëndetit Publik Tiranë**, përfaqësuar nga **Punëdhënësi, Drejtori** z. Alban **Ylli** dhe **Punëmarrësit, Kryetari i Këshillit Sindikal të I.SH.P**, anëtar i **F.S.SH.Shqipërisë**, z.Dritan **Ulqinaku**.

-Kjo Kontratë Kolektive Pune, mbron **Gjithsej**, punjonjës, ku prej tyre janë: **Mjekë të Përgjithshëm/të Familjes**, **Mjekë Specialistë**, **Infermiere** dhe **Staf ndihmës**, të punësuar në këtë Institucion Kombëtar.

7.Mbrojtje të anëtarëve

-Gjatë këtij viti, kemi mbrojur juridikisht, profesionalisht dhe financiarisht, **17 punonjëse, Infermiere**, të pushuara nga puna me urdhër të Drejtores të Qendrës Shëndetësore në qytetin e **Pogradecit**, të cilët mbas dy muajsh përpjekjesh kemi mundur ti rikthejmë në vendet e tyre të punës, pa pasoja të mëtejshme, duke pushuar nga funksioni drejtoresh urdhëruese të vendimit.

-Gjithashtu kemi realizuar rikthim në punë edhe të një **Mjeku** nga **Vlora**, të pushuar nga puna, prej Drejtores të institucionit aty.

8.Pagat dhe Shpërblimet

-Gjatë vitit **2008**, me **Vendim të K.Administrativ të I.S.K.Shëndetësor**, prej Muajit **Korrik**, paga mesatare u rrit **10%**, e diferencuar për Mjekët sipas pozicioneve/zonave gjeografike, ku u rrit **16%**, për **Mjekët që punojnë në qendër dhe në zonat fushore**, ku përfituan rreth **1200 Mjekë** (70% e numrit total), kurse për **Mjekët e zonave të tjera përfituan rritje nga 3-10%**. **Mjekët specialistë të Q.Shëndetësore të Shërbimit Parësor në Rrethe**, patën një rritje mesatare prej **10%**, ku nga kjo rritje përfituan

rreth 1670 Mjekë të Përgjithshëm/të Familjes dhe 270 Mjekë Specialistë. Personeli Infermieristik pati rritje mesatare prej 14%, kurse punonjësit e tjerë me 10%, ku nga kjo rritje përfituan rreth 6700 Infermiere dhe 700 Punonjës të tjerë.

-Gjatë vitit 2008, me Vendim të K.Administrativ të I.S.K.Shëndetësor, prej Muajit Korrik, u rritën pagat e punonjësve të Administratës, mesatarisht me 8%, ku pagat e ulëta dhe të mesme u rritën deri në 12%, ndërsa pagat e larta deri në 4%, ku përfituan Gjithsej 487 punonjës.

-Gjatë vitit 2008, me Vendim të K.Administrativ të I.S.K.Shëndetësor, prej Muajit Korrik, Punonjësit e Spitalit të Durrësit (pjesë e skemës të I.S.K.Sh-së) patën një rritje page mesatarisht prej 18.7%, ku prej tij përfituan 701 punonjësit e këtij spitali.

-Edhe gjatë vitit 2008 (prej vitit) në zbatim të Kontratës Kolektive të Punës të nënshkruar dt. 05/06/2006, me afat 3-vjeçar, midis I.S.K.SH-së, nga Drejtore e Përgjithshme z.Elvana Hana dhe nga Presidenti i F.S.SH.SH-së, z.Minella Mano, si dhe V.K.A. nr.9, dt.30/07/2008, për udhëzimet përkatëse, të gjithë punonjësit e Shërbimit Parësor, kanë marrë nga 2(dy) paga mujore Shpërblim, gjatë Muajit Korrik dhe Dhjetor.

9.Trajnime/Kualifikime

-Nevojat e edukimit, për kualifikime të gjera dhe të veçanta aktualisht janë të mëdha edhe për F.S.SH.SH-në dhe të gjitha strukturat që janë pjesë përbërëse të saj, e sidomos ato që janë më të reja në tregun sindikal, por edhe ato seksione, që për disa shkaqe dhe arsye, ndodhen sot në gjendje të vështira, përse i përket aktiviteteve dhe nivelit profesional që ato ofrojnë ndaj anëtarëve dhe njerëzve të tjerë të interesuar.

-F.S.SH.SH-ja ka një eksperiencë të gjatë të edukimit sindikal dhe gjithmonë e ka konsideruar si një dimension kyç i veprimtarisë së saj.

-Në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Friedrich Ebert, zyra Tiranë, ka organizuar me kërkesën dhe në bashkëpunim me F.S.SH.SH-së, Seminar kualifikimi/trajnimi, në Tiranë, në Berat, me pjesëmarrjen anëtareve, të drejtuesve të zgjedhura, të punësuar në sektorin e shërbimeve shëndetësore.

-Janë trajtuar tema si: **Sindikatat dhe Roli i tyre, Statuti dhe Vendimmarrjet Demokratike, Kontratat Kolektive të Punës, Dialogu Social** dhe të tjera leksione, bazuar në kërkesat dhe nevojat e kohës.

10.Projekte

Gjatë realizimit të këtij projekti Informimi-kualifikimi u financuan për **2(dy) vjet 4300 Euro**, ku **3800 Euro** nga **Financuesit** dhe **500 Euro** nga **F.S.SH.SH-së**.

-Në bashkëpunim me **Fondacionin Gjerman Friedrich Ebert**, zyra **Tiranë**, ka organizuar me kërkesën dhe në bashkëpunim me F.S.SH.SH-së, **Seminar kualifikimi/trajnimi**, në **Tiranë**, në **Berat**, me pjesëmarrjen anëtareve, të drejtueseve të zgjedhura, të punësuar në sektorin e shërbimeve shëndetësore. Janë trajtuar tema si: **Sindikatat dhe Roli i tyre, Statuti dhe Vendimmarrjet Demokratike, Kontratat Kolektive të Punës, Dialogu Social** dhe të tjera leksione, bazuar në kërkesat dhe nevojat e kohës.

-**Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë**, në bashkëpunim me **Federatën Greke të Punonjësve të Spitaleve Publike**, bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar midis tyre, mbas aplikimit fituan **Projektin European Intereg III-A, Greqi-Shqipëri**.

-Projekti synonte: **Kualifikimin e punonjësve sindikalistëve, të Spitaleve Publike të dy vendeve**, i cili u zhvillua në **Janinë-Greqi**, prej dt, **13-23 Tetor 2008**, ku nga **Shqipëria** morrën pjesë **40(dyzet) Mjekë/e** dhe **Infermierë/e**, nga **Tirana, Durrësi, Vlora, Berati, Kuçova, Gjirokastra, Lushnja, Saranda, Korça, Devolli, Elbasani, Gramshi, Shkodra, Puka, Burreli**, etj, prej të cilëve **20(njëzet) ishin të rinj** në moshë, numri më i madh ishin femra, si anëtare dhe jo anëtarë të Federatës së Shëndetësisë.

Janine 13-23 Tetor 2008



Tirane 21 Nentor 2008



Informacion

Aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit 2009,
nga
Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë

Aktivitetet kryesore që do të zhvillohen gjatë vitit 2009, do të jenë:

a-Zbatimi i Statutit të F.S.SH.Shqipërisë.

b-Kryerja e Detyrave dhe Marrja e Përgjegjësisë prej gjithsecilit.

c-Korrigjimi i Mangësive dhe Mosrealizimeve, të krijuara gjatë kësaj periudhe diktuar nga shkaqe dhe faktorë të ndryshëm.

d-Realizimi i Takimeve, Mbledhjeve, me të zgjedhurit dhe seksionet sindikale në institucionet e ndryshme të vendit.

e-Informimi i Anëtarësisë rreth Zhvillimeve në Sektorin e Përkujdesjes Shëndetësore, Reformat në Sektorin Parësor dhe Spitalor, strukturimi, menaxhimi, kualifikimi, konkurrimi, punësimi, pagat, shpërblimet, legjislacioni vendas dhe konventat ndërkombëtare, etj.

f-Tërheqja e Mendimeve dhe Propozimeve të Anëtarësisë, lidhur me gjithçka që ka të bëjë me ecurinë e lëvizjes sindikale.

g-Informimi i Anëtarësisë, me mjete dhe mënyra të ndryshme, rreth Zhvillimeve, Arritjeve, Mosarritjeve, Kundërshtive dhe Pengesave të hasura, gjatë Aktivitetit Sindikal të F.S.SH.Shqipërisë, në të gjitha nivelet e strukturave.

h-Përzgjedhja e Propozimeve, Studimi dhe Listimi i Përparësive.

i-Përgatitja e Grupit të Punës, Programit të Punës, për hapjen e Fushatës Zgjedhore, të Kongresit të III-të, të F.S.SH.Shqipërisë, i cili do të mbahet gjatë Muajit Tetor 2009.

j-Informimi i Strukturave Zgjedhore dhe Anëtarësisë, lidhur me Objektivat.

k-Forcimi, Funkcionalizimi, Rikonceptimi dhe Demokratizimi i Strukturave.

l-Përgatitja e Kërkesave për Zgjidhje që F.S.Sh.Shqipërisë, do të miratojë në Kongres dhe do të drejtojë Qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të

Barabarta, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Institucioneve të tjera Punëdhënëse dhe Partnere.

m-Ndjekja e Përfundimeve, Rezolutave, Vendimeve dhe Detyrave konkrete të Kongresit të III-të, të F.S.SH.Shqipërisë.

n-Ndjekja dhe zbatimi i detyrave të përditshme dhe funksionimi në vazhdimësi i të gjithë strukturave të Federatës, bazuar në përgjegjësitë e gjithsecilit dhe të grupimit.

**I-Konferenca e Parë e Gruas,
të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë,
do të mbahet gjatë Muajit Qershor 2009**

-Puna me gratë/femrat dhe investimi për ofrimin, bashkëpunimin dhe kualifikimin e tyre, **ngelet nevojë dhe domosdoshmëri**, për strukturat tona profesionale dhe sindikale, prandaj po përgatitemi për të organizuar **Konferencën e I-rë, të Grave të F.S.SH.SH-së, gjatë Muajit Qershor 2009, për të cilën do të financohen-shpenzohen nga Federata rreth 240.000 mijë lek.**

-Në konferencë do të marrin pjesë, të zgjedhurit e Strukturave kryesore të F.S.Sh.Shqipërisë, kryetarët e Seksioneve Sindikale të Shëndetësisë, të Qarqeve, drejtueset e strukturave të Grave, anëtare dhe studente e të punësuarra të reja, në Institucionet e ndryshme të Shëndetësisë, ku funksionojnë apo mendohet të funksionojnë strukturat tona sindikale.

-Konferencën do ta drejtojë Kryetarja e Gruas të F.S.SH.Shqipërisë, njëkohësisht zv.Presidente dhe Anëtarë e Kryesisë të Federatës, dr. Benereta Hoxha, si dhe nga Kryesia e Presidenti i Federatës.

-Paraprakisht do të tërhiqen mendime nga anëtarësia e Grave/e Femrave gjatë takimeve dhe komunikimit me to, ku më pas do të listohen nevojat dhe detyrat që duhet të zgjidhen, sikurse do të përgatiten kërkesat që do të miratohen edhe në Kongresin e III-të të F.S.SH. Shqipërisë, që do të mbahet gjatë muajit Tetor 2009.

-Jemi duke përgatitur edhe një **Fletë-Palosje dhe Pastera informues**, për **Gratë/për Femra**, të cilat do ti ofrojmë atyre në vendet e punës dhe të studimit, por edhe gjatë realizimit të seminareve apo takimeve të ndryshme që do të realizohen nga strukturat tona, në vazhdimësi.

II-Gjatë Gjashtëmuorit të I-rë, viti 2009,

-Do të punohet për **zbatimin e Projektit**, fituar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, **financuar nga Fondacioni Fridrich Ebert Shtiftung (F.E.S)**, zyra Tiranë, **zbatuar nga F.S.SH.Shqipërisë**, me temë: **“Zhvillimi i Dialogut në Institucionet e Shëndetësisë të Shqipërisë”**, me Aktivitetin dhe synimin kryesor, **Trajnimi i Trajnerëve të Rinj**.

-Kjo, si nevojë e Federatës për të krijuar një strukturë udhëheqëse të aftë për të bërë ndryshime, për të tejkaluar vështirësitë dhe për të krijuar një qëndrueshmëri në **Lidershipin e Sindikatës**, pra për të trajnuar/kualifikuar njerëzit e rinj, me qëllim **krijimin e një baze vetëgjeneruese të edukimit dhe të zbatimit praktik të ideve e synimeve të tyre**.

-**Trajnimi do të menaxhohet nga Përfaqësuesi i Rinisë të Federatës së Shëndetësisë**, dr. Erion Dobi, nga Kryesia, nga Presidenti i F.S.SH. Shqipërisë, si dhe do të realizohet nga Drejtues dhe Specialistë të Federatës së Shëndetësisë dhe në bashkëpunim me Institutin e Studimeve të Marrëdhënieve të Punës (I.S.M.P.)

Më dt.23 Janar 2009,

-**Ditën e Premte, ora 12.00, në Hotel “Doro” Tiranë**, në zbatim të Projektit, **“Zhvillimi i Dialogut në Institucionet e Shëndetësisë të Shqipërisë”**, me aktivitetin dhe synimin kryesor, **Trajnimi i Trajnerëve të Rinj**, nga F.S.SH.Shqipërisë në bashkëpunim me Fondacionin Fridrich Ebert Shtiftung (F.E.S), zyra Tiranë, **u organizua Seminari Kualifikues, i cili filloi me Hapjen e Projektit** e më pas sipas Programit të punës u zhvilluan temat/leksionet konkrete, me temat: **“Çjanë Sindikatat”** dhe **“Mendimi i të Rinjve dhe bashkëpunimi konkret i strukturave, garantojnë jetëgjatësi sindikale dhe zhvillim profesional e shoqëror”**.

-**Seminari u realizua me pjesëmarrjen e Studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, me Mjekë, me Juristë, Specializantë, Pedagogë të rinj dhe Specialistë të Institutit të Studimeve të Marrëdhënieve të Punës**.

-**Në seminar ishin të pranishëm rreth dyzet të rinj, ku 22 prej tyre ishin Femra**.

-Gjatë seminarit **u realizua edhe pyetëtori, mbi nevojën e kualifikimit me pjesëmarrësit**, për të mësuar më shumë rreth njohurive dhe interesave që kanë apo që dëshirojnë të kenë të rinjtë studentë dhe mësime të Fakultetit të Mjekësisë, dhe për të drejtuar vëmendjen tonë në ato çështje që kërkojnë interes dhe ndikojnë në informimin cilësor të tyre, për ti bërë ata më të aftë për të njohur zhvillimin e tregut, arsimimin, punësimin, të drejtat, legjislacionin vendas dhe konventat ndërkombëtare, **për të mësuar më shumë për grupimet e interesit, për sindikatat e profesioneve dhe për shoqërinë e sotme dhe atë të ardhmen, me qëllim që të reagojnë drejt, për të mbrojtur të drejtat e tyre, të kolegëve të tyre, si dhe të ndikojnë pozitivisht në ndryshimet dhe në përmirësimin e jetës së tyre.**

Tirana, 23 janar 2009



Vlora, 03 Prill 2009



Durrës, 09 prill 2009



-Projekti synon të realizojë informimin/edukimin/trajnimin e studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, të Qytetit të Tiranës, dhe të rinj të tjerë studentë dhe të punësuar, në institucionet e Kujdesit Shëndetësor të Qarkut Durrës dhe Vlorë.

-Gjatë këtij seminari kualifikues u evidentuan nevojat që të rinjtë e viteve të ndryshme të fakultetit të Mjekësisë, kanë për të qënë më të informuar rreth të drejtave të tyre si të rinj, rreth konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas, rreth tregut të punës, rreth punës së zezë/tregut informal, rreth mundësive të punësimit në sektorin publik, brenda profesionit dhe vendit, rreth punësimit jashtë vendit, në profesion apo jashtë ti, rreth papunësisë, rreth dhunimit të të drejtave gjatë arsimimit dhe pas tij, gjatë marrëdhënieve të punës, rreth rolit të grupimeve të interesit dhe konkretisht sindikatave të profesionit, **ndihmës dhe hapësirave që këto struktura mund ti krijojnë atyre që dëshirojnë ti bashkohen këtij grupimi, rreth shoqërisë demokratike dhe pluralizmit të mendimeve dhe anëtarësimit në grupime, etj.**

-Ne mundëm të kuptojmë respektin e treguar prej pjesëmarrësve studentë gjatë këtij trajnimi, si dhe dilemën e tyre, lidhur me atë çka ata nuk njohim mirë nga sindikatat në përgjithësi dhe nga Sindikata e Shëndetësisë në veçanti, kjo për faktin e mosnjohjes nga njëra anë, sepse kanë munguar si interesimet e vetë studentëve për këto organizime dhe struktura profesionale, por edhe të tjera grupimeve të shoqërisë, që aktualisht gjenden dhe kontribuojnë në tregun e vështirë Shqiptar.

-Në këtë drejtim, kanë penguar edhe mungesa e vizionit tonë si sindikata, që duhej të ishim dhe të jemi më prezent pranë studentëve, pranë të rinjve në kualifikim dhe specializim, por edhe për pamundësinë tonë nsur nga

mungesa e kapaciteteve dhe e burimeve të nevojshme, për të realizuar këtë nevojë, sikurse kuptuam se është në detyrën tonë si grupim, që të punojmë që sot me të rinjtë në studim, për ti krijuar jo vetëm atyre mundësinë e ofrimit dhe dhënies të mendimit dhe kontributit konkret nga brenda strukturave sindikale, por edhe që të mundësojmë ndryshimin jo vetëm të moshës, të koncepteve, por edhe të ideve dhe të praktikave ndryshe, që të trashëgojmë breza më të rinj në drejtim të sindikatave të ardhshme, pra të punojmë duke i ndihmuar të rinjtë dhe duke përfituar prej tyre, por pa i penguar ata dhe ato të rinj, as sot, që të konkurrojnë dhe të drejtojnë sindikatat nesër.

-Ky është vizioni ynë si drejtues, të këtij grupimi juridik, shoqëror, ekonomik dhe profesional, prandaj ne edhe nëpërmjet këtij projekti dhe bashkëpunimi konkret e në vazhdim, do të mund ti shërbejmë atyre, arsimimit, kualifikimit, edukimit, profesionalizmit, përgjegjësisë sindikale, qytetare dhe zhvillimit të shoqërisë.

-Mbas njohjes, takimeve dhe informimit të tyre, synohet ofrimi dhe nxitja e interesimit të Studentëve dhe Mjekëve, Pedagogëve më të Rinj, për tu ofruar pranë strukturave tona sindikale, për të kontribuar konkretisht, për të konkurruar, për të sjellë frymën dhe mendimin e ri.

-Në përfundim të Projektit synohet të krijohet një Grup/Strukturë Liderësh/Drejtuesish dhe Trajnuesish të Rinj, të përzgjedhur, pranë Federatës së Shëndetësisë, për të qenë të aftë të njohin, të kuptojnë, të vlerësojnë, të studiojnë dhe të rrisin kapacitetet profesionale të Grupimit.

-Nga realizimi i Projektit European Intereg III-A, Greqi-Shqipëri, i cili synonte **Kualifikimin e punonjësve sindikalistëve, të Spitaleve Publike të dy vendeve**, i cili u zhvillua në **Janinë-Greqi**, prej dt, **13-23 Tetor 2008**, ku nga F.S.SH.Shqipërisë morrën pjesë **40 Mjekë dhe Infermierë**, një pjesë **anëtarë** dhe të tjerët, **më të rinjtë jo anëtarë**, por disa prej tyre aktivistë të rinj, **realizuan njohjen dhe informimin e tyre**, me synim edhe **ofrimin e tyre pranë strukturave tona**, me qëllim që të reformojmë konceptet dhe strukturat në të ardhmen e afërm, për të garantuar vazhdimësi sindikale bashkëkohore, për të konkurruar profesionalisht në tregun e vështirë të shoqërisë.

-Aktualisht jemi duke bashkëpunuar me disa prej tyre në institucionet dhe Qytetet ku ata jetojnë dhe kontribuojnë, si në Durrës, në Korçë, në Gjirokastrë, në Gramsh, etj.

-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, (F.S.SH.SH-ja), nisur nga nevoja dhe domosdoshmëria e rifreskimit të strukturave drejtuese dhe vendimmarrëse, si dhe rikonceptimit të politikave dhe vizionit të tyre, prej disa vitesh **ka punuar konkretisht për të ofruar më shumë të rinj,** (të punësuar, të papunë dhe nxënës e studentë të shkollave dhe Fakulteteve/Universiteteve të ndryshme), pranë sindikatës, me qëllim/me synim informimin e tyre, nxitjen, anëtarësimin, **angazhimin dhe marrjen e përgjegjësi konkrete prej tyre,** duke ngritur edhe strukturat e Rinisë, bazuar në statutin, rezolutën dhe projektet, studimet përkatëse, aktivitete/investime këto që kanë rezultuar pozitive dhe me interes të ndërsjellë.

Pagat dhe Shpërblimet

-Gjatë vitit 2009, me Vendim të K.Administrativ të I.S.K.Shëndetësor, prej Muajit **Maj,** paga **mesatare do të rritet me 15%,** e diferencuar për Mjekët sipas pozicioneve/zonave gjeografike dhe kriterëve vlerësues, ku do të rriten:

-Për Mjekët e Përgjithshëm dhe të Familjes-M.P.F.

(me ngarkesë 2000 banorë, vjetërsi maksimale 25 vjet punë) që punojnë:

a-në qendër me 16,32% (ritje me vlerë **6.500** lekë),

ku paga ishte **39.835** dhe bëhet **46.335** lekë,

b-në zonat fushore me 11,26% (ritje me vlerë **5.500** lekë),

ku paga ishte **48.835** dhe bëhet **54.335** lekë,

c-në zonat kodrinore me 8,73% (ritje me vlerë **4.700** lekë),

ku paga ishte **53.835** dhe bëhet **58.535** lekë,

d-në zonat malore me 6,84% (ritje me vlerë **4.500** lekë) dhe

ku paga ishte **65.835** dhe bëhet **70.335** lekë,

e-në zonat e thella me 3,98% (ritje me vlerë **3.000** lekë),

ku paga ishte **75.335** dhe bëhet **78.335** lekë,

ku nga kjo ritje **përfitojnë rreth 1200 Mjekë** (70% e numrit total të të punësuarve në Qendra), kurse për **Mjekët e zonave të tjera** (30% e numrit total të të punësuarve).

-Mjekët specialistë të Q.Shëndetësore të Shërbimit Parësor në Rrethe, do të kenë një **ritje mesatare prej ...%,** ku nga kjo ritje do të **përfitojnë rreth 1670 Mjekë të Përgjithshëm/të Familjes dhe 270 Mjekë Specialistë.**

-Personeli Infermieristik do të ketë një rritje mesatare prej 14%, kurse punonjësit e tjerë me ...%, ku nga kjo rritje përfituan rreth 6700 Infermiere dhe 700 Punonjës të tjerë. Do të përfitojnë Gjithsej 9350 punonjës. Ky vendim u miratua në Mbledhjen e dt. 09/07/2009, të K.Administrativ të I.S.K.SH-së.

-Gjatë vitit 2009, me Vendim të K.Administrativ të I.S.K.Shëndetësor, prej Muajit Maj, do të rriten pagat e punonjësve të Administratës, mesatarisht me ...%, ku pagat e ulëta dhe të mesme u rritën deri në ...%, ndërsa pagat e larta deri në%, ku do të përfitojnë Gjithsej 580 punonjës. Ky vendim u miratua në Mbledhjen e dt. 09/07/2009, të K.Administrativ të I.S.K.SH-së.

-Gjatë vitit 2009, me Vendim të K.Administrativ të I.S.K.Shëndetësor, prej Muajit Maj, Punonjësit e Spitalit të Durrësit (pjesë e skemës të I.S.K.Sh-së) do të kenë një rritje page mesatarisht prej 15.%, ku prej tij do të përfitojnë 701 punonjësit e këtij spitali. Ky vendim u miratua në Mbledhjen e dt. 09/07/2009, të K.Administrativ të I.S.K.SH-së.

-Edhe gjatë vitit 2009, në zbatim të Kontratës Kolektive të Punës të nënshkruar dt. 05/06/2006, me afat 3-vjeçar, midis I.S.K.SH-së, nga Drejtore e Përgjithshme z.Elvana Hana dhe nga Presidenti i F.S.SH.SH-së, z.Minella Mano, si dhe V.K.A. nr.9, dt.30/07/2008, për udhëzimet përkatëse, të gjithë punonjësit e Shërbimit Parësor, të Administratës, do të marrin nga 2(dy) paga mujore Shpërblim, gjatë Muajit Korrik dhe Dhjetor. Ky vendim u miratua në Mbledhjen e dt. 09/07/2009, të K.Administrativ të I.S.K.SH-së.

III-Gjatë Muajit qershor 2009,

-Do të realizohet Konferenca përmbyllëse e Projektit, me pjesëmarrjen e kontribuuesve konkretë, pjesëmarrësve, studentëve dhe të rinjve të trajnuar si dhe drejtuesve kryesorë të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, të Institutit të Studimeve të Marrëdhënive të Punës, të Fondacionit Fridrich Ebert Shtiftung (F.E.S), ku edhe do të bëhet certifikimi i tyre.

IV-Gjatë vitit 2009-2010,

-Do të zbatohet **Projekti** i fituar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, financuar nga P.S.I.(Shërbimet Publike Ndërkombëtare dhe F.O.A-Danimarkë), zbatuar nga F.S.SH.Shqipërisë, me temë: “**Çfarë presin të Rinjtë nga Sindikata**”.

Gjatë realizimit të këtij projekti Informimi-kualifikimi do të financohen për **2(dy) vjet, 15.000 Euro**, ku **13.000 Euro** nga **Financuesit** dhe **2000 Euro** nga **F.S.SH.SH-së**. **Projekti do të realizohet në Fakultetin e Infermierisë, Tiranën, Vlorë, Korçë dhe tashmë shtohen Fakultetet e Qyteteve të Elbasanit dhe Shkodrës**. Jemi në Fazën e përgatitjes të materialeve informuese dhe kualifikuese, ku më pas në fillim të Janarit 2009 do të fillojmë zbatimin konkret të tij në terren.

Mbas njohjes, takimeve dhe informimit të tyre, synohet ofrimi dhe nxitja e interesimit të studentëve për tu ofruar pranë strukturave tona sindikale, për të kontribuar konkretisht, për të konkuruar, për të sjellë frymën dhe mendimin e ri, për të shtuar numrin e anëtarësisë, sidomos të të rejave/ femrave, si dhe për të tu bërë pjesë e vendimmarrjes dhe drejtimit të niveleve dhe strukturave të ndryshme të Federatës, për të garantuar sindikalizmin bashkëkohor dhe jetëgjatësinë funksionale të Sindikalizmit.

-Projekti drejtohet dhe menaxhohet nga Përfaqësuesi i Rinisë, dr. Erion Dobi, si dhe nga Kryesia e Presidenti i F.S.SH.Shqipërisë, dr. Minella Mano.

Gjatë zbatimit të Projektit realizohet informimi i vazhdueshëm i Partnerëve dhe Financuesve të tij, të cilët dërgojnë individët përgjegjës për të marrë pjesë konkretisht në Shqipëri.

Ky Projekt është vazhdim i atij të realizuar gjatë viteve 2006-2007, në Fakultetet e Infermierisë, të Qyteteve të Tiranës, Korçës, Vlorës, i cili rezultoi i efektshëm, ku në përfundim të studimit, bazuar në pyetëtorin përkatës u zhvillua edhe **Konferenca e Dytë e Rinisë së F.S.SH.Shqipërisë**, më **dt. 23 Prill**, ditën e **Hënë**, ora **09.30**, me temë: “**Për të Rinjtë dhe me të Rinjtë të ndryshojmë**” në të cilën vetë të rinjtë/studentët diskutuan dhe nxorrën përfundim konkrete, për vazhdimin e punës, duke ushtruar vendimmarrjen dhe demokracinë statutore.

-Pra, ekziston një eksperiencë dhe rezultat konkret, pozitiv, i cili na mundëson të korrigjojmë disa mënyra pune dhe të përqëndrohemi më mirë

aty ku edhe interesi ynë na dikton, sidomos në Pedagogët e rinj të këtyre Institucioneve të cilët na krijojnë më shumë hapësira, njohje dhe na shtojnë konkretisht anëtarësinë, sidomos kualitetet profesionale dhe cilësinë shoqërore.

-Jemi duke zbatuar me korrektësi dhe përparësi **Rezolutën e Rinisë të F.S.SH.Shqipërisë**, të propozuar nga Strukturat e Rinisë dhe të **miratuara në Kongresin e II-të, të F.S.SH.Shqipërisë**, mbajtur në **Tiranë, dt. 23 Tetor 2004**.

Gjatë Muajit Mars 2009,

-Në dt.**13** (ditën e premte) dhe **20** (ditën e premte) **Mars**, do të organizohen takimet në Qarqet e **Vlorës** dhe të **Durrësit**, për **zbatimin e Projektit**, fituar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, **financuar nga Fondacioni Fridrich Ebert Shtiftung (F.E.S)**, zyra Tiranë, **zbatuar nga F.S.SH.Shqipërisë**, me temë: **“Zhvillimi i Dialogut në Institucionet e Shëndetësisë të Shqipërisë”**, me Aktivitetin dhe synimin kryesor, **Trajnimi i Trajnerëve të Rinj**.

-**Seminari do të realizohet me pjesëmarrjen e Studentëve të Fakultetit të Infermierisë**, me **Infermierë të rinj të punësuar**, me **Mjekë**, me **Juristë**, me **Sociologë**, me **Psikologë**, me **Specializantë**, me **Pedagogë të rinj** dhe me **Specialistë të Institutit të Studimeve të Marrëdhënieve të Punës**.

Gjatë Muajit Mars-Prill-Maj 2009,

-Do të realizohen **takime me të Zgjedhurit** dhe **me Seksionet e Këshillat Sindikale të Shëndetësisë**, në Qytetet dhe Qarqet e vendit.

Gjatë Muajit Qershor 2009,

-**Mbasi të miratohet plani i punës dhe programi përkatës, në Strukturat Statutore**, do të **hapet fushata për zgjedhjet e reja në të gjitha nivelet e strukturave të Federatës së Shëndetësisë**, duke informuar, takuar dhe dëgjuar vërejtjet dhe propozimet konkrete të çdo anëtari, apo grupimi sindikal që kontribuon në institucionet e ndryshme të shërbimit shëndetësor të vendit.

-Gjithashtu **do të ngrihen grupet e punës specifike**, si për **statutin**, për **organizimin**, për **trajnimin**, për **edukimin**, etj, me **drejtues** dhe me **specialistë**, për të korrigjuar gjithçka që nuk ka rezultuar efektive dhe zhvilluese pozitive, për të mundësuar zgjedhjet dhe alternativat konkurruese.

-Do të shpallen **kandidaturat konkurruese** për zgjedhjet e reja, që do të realizohen gjatë **Muajit Tetor 2009**, kur të mbledhet **Kongresi i III-të**, i **F.S.SH.Shqipërisë**.

-Do të përcaktohet numri i delegatëve që do të përfaqësojnë **Anëtarësinë e tyre**, Profesionet, Shërbimet dhe Institucionet e Shërbimit Shëndetësor, në **Kongresin e III-të**. bazuar në nenet përkatëse të Statutit të Federatës.

-Do të realizohen **Materialet Informuese** për të gjithë njerëzit e punësuar, të interesuar për Federatën dhe kontributin tonë.

Gjatë Muajit Korrik-Gusht 2009,

-Do të bashkëpunohet për të realizuar zgjedhjet në strukturat e **Këshillave** dhe të **Seksioneve Sindikale të Institucioneve**, ku funksionon **anëtarësia jonë** dhe sidomos në ato **Institucione** ku për shkaqe të **ndryshme nuk ka patur organizim Federata**, por që **kërkohet apo ne dëshirojmë të kemi**, me qëllim jo vetëm rifreskimin e tyre, por edhe të rinovimit dhe forcimit të mendimit dhe të aktivitetit konkret.

-Gjatë realizimit të zgjedhjeve, prej kolegëve vendas, përgjegjës dhe të deleguar për ndjekjen e tyre, **duhet të bëhet kujdes që të respektohen normat, etika, dijet, qëndrimet, kontributi dhe statuti i F.S.SH.Shqipërisë**.

Gjatë Muajit Shtator-Tetor 2009,

-Do të planifikohen dhe rezervohen/porositen **Shpenzimet** për **Kancelari**, për **Shtypshkrime**, për **Postera**, për **Vendin/Sallën** ku do të mbahet **Kongresi**, për **Dietat** dhe gjithçka që kërkon ky organizim.

-Gjithashtu do të punohet për **përgatitjen e materialit bazë, Raportit**, që do të mbahet në emër të **Anëtarëve** dhe **Strukturave të zgjedhura**, nga **Presidenti i F.S.SH.Shqipërisë**, mbi zhvillimet dhe realizimet, mbi

vështirësitë dhe mosrealizimet dhe gjithçka tjetër që mendohet të realizohet nga ky grupim gjatë viteve në vazhdim.

-Do të punohet për **përgatitjen e Rezolutave** (për **Rininë**, për **Gruan**, për **Trajnimin**, për **Demokratizimin**, etj), që **Kongresi i III-të bazuar në nevojat dhe propozimet konkrete të strukturave përgjegjëse/përkatëse, do të miratojë**, për ndjekje dhe zbatim të tyre me përparësi në të ardhmen.

TIRANË, Dt. 23 TETOR 2009,
KONGRESI i III-të
I FEDERATËS SË SINDIKATAVE
TË SHËNDETËSISË SË SHQIPËRISË

-Pas Kongresit të III-të,
gatë Muajit **Nëntor-Dhjetor 2009,**
do të përqëndrohemi në vazhdimin e detyrave të përditshme dhe objektivave të miratuara nga strukturat përkatëse të Federatës së Shëndetësisë, përfundimin dhe Analizimin e Projekteve, si dhe realizimin e çdo detyre nga individët dhe nivelet përgjegjëse, nëpërmjet kryerjes me korrektësi dhe përgjegjësi juridike e profesionale të Aktiviteteve konkrete.

Presidenti i F.S.SH.SH

Dr. **Minella MANO**

STRATEGJIA E EDUKIMIT TË F.S.SH.SH-së

Për Trajnimin - Edukimin Profesional Viti 2009

Qëllimi dhe objektivat

Në zbatim të detyrave dhe të objektivave kryesore të përcaktuara dhe të miratuara nga Kongresi i fundit i F.S.SH.SH-së, në kuadrin e riorganizimit, reformatimit strukturor dhe rritjes së njohurive dhe nivelit kualitativ të të gjitha strukturave të Federatës, edukimi-kualifikimi profesional dhe sindikal është vlerësuar si një nevojë dhe domosdoshmëri, një element i rëndësishëm ky, për progresin e përgjithshëm të funksionimit të gjithë strukturave të Federatës.

Disa nga burimet materiale dhe njerëzore, ku do të mbështet F.S.SH.SH-ja, për realizimin e Kualifikimit Profesional:

- Përvoja pozitive lidhur me informimin dhe edukimin.
- Kapacitetet për bisedime dhe komunikim efektiv.
- Eksperiencat pozitive nga Kontratat Kolektive dhe Individuale të Punës.
- Burimet njerëzore dhe kapacitetet edukuese-trainuese, brenda kryesisë të F.S.SH.SH-së.
- Prania trainuese profesionale dhe sindikale, në strukturat e seksioneve sindikale.
- Prania e trainerëve-lektorëve në qendër dhe në rajonet-qarqet kryesore.
- Prania e materialeve që mund të përdoren si bazë për trainimet edukuese.
- Prania e botimeve, librave dhe literaturës (të vendit apo të huaj).
- Prania e studimeve të realizuara.
- Prania dhe mundësia e ideimit, ndërtimit dhe zbatimit të projekteve.
- Bashkëpunimi me Institutin e Studimeve të Marrëdhënieve të Punës (I.S.M.P).
- Bashkëpunimi me Kolegë dhe Trainues-Mësimdhënës, jashtë strukturave sindikale.

Objektivat e Edukimit-Kualifikimit të F.S.SH.SH-së.

- Informimi i Vazhdueshëm dhe Bashkëkohor i anëtarëve.
- Motivimi i Anëtarëve dhe Simpatizantëve.
- Forcimi i Lëvizjes Sindikale dhe Profesionale.

- Rinovimi i Strukturave sindikale.
- Forcimi i Seksioneve sindikale.
- Rritja e Pjesëmarrjes të të Rinjve (nxënës, studentë, të punësuar, të papunë)
- Rritja e Pjesëmarrjes të Grave-Femrave në strukturat sindikale.
- Rritja e Pjesëmarrjes dhe Marrjes së Përgjegjësive prej Anëtarëve.
- Demokratizimi i Vendimmarrjeve.
- Respektimi i Statutit dhe Normave.
- Mësimi i Realizimit të Bisedimeve dhe Komunikimit pozitiv.
- Domosdoshmëria e Funkcionimit të Dialogut Social.
- Kualifikimi i Individëve dhe Njësive të veçanta për të aplikuar me Projekte.
- Forcimi i Sistemit të Brendshëm të Edukimit.
- Nxitja midis Individëve dhe Strukturave, për të Konkurruar.
- Rritja e Burimeve Financiare nga Federata,
- për të mbështetur aktivitetet edukuese - trainuese.
- Ngritja e Grupeve të Punës, që do të realizojnë Edukimin-Trainimin.
- Garantimi i Vazhdimësisë të Aktivitetit të F.S.SH.Shqipërisë.

-Për të realizuar këto qëllime, Bashkëveprimi i Strukturave të F.S.SH.SH-së: do të realizohet: me Institucione Studimore Private, (brenda ose jashtë vendit), me Universitete Publike apo Private, me Fondacione, me Shoqata, me Sindikata Profesionesh, (brenda ose jashtë vendit), me Konfederata, (brenda ose jashtë vendit), me Punëdhënës, Publikë apo Privatë, me Përfaqësi të Institucioneve Ndërkombëtare (brenda ose jashtë vendit), me studiues, me mësimdhënës, me kolegë, etj.

-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, (F.S.SH.SH-ja), nisur nga nevojat, kërkesat e anëtarëve dhe strukturave sindikale, ka miratuar në Kongresin e kaluar 2 (dy) rezoluta, 1(një) për Gruan dhe 1(një) për Rininë, ku një vëmendje më e madhe do të përqëndrohej për informimin dhe kualifikimin-edukimin e tyre të vazhueshëm, edukim i cili ka sjellë rezultatet pozitive, sikurse duhet patur kujdes për përzgjedhjen e atyre individëve që do të mund të kryejnë funksionin e Trainuesit në të ardhmen.

-F.S.SH.SH-ja është përfshirë në një proces domethënës reformash, më qëllim në veçanti konsolidimin e strukturave të saj profesionale, për të bërë të mundur që ato të zhvillojnë aktivitetin e tyre konkret dhe cilësor, si në sektorët e shërbimeve publike, ashtu edhe në ato private, për të organizuar dhe përfaqësuar punëtorët-të punësuarit e të niveleve të shërbimit.

-Struktura e Rinisë ka adoptuar/përshtatur të njëjtën strukturë si Rrjeti i Gruas, me të cilin bashkëpunon ngushtë. Rrjeti i Rinisë

mbështetet nga një Departament i Rinisë që ka buxhetin e tij. Objektivi kryesor është dhe ngelet, zgjerimi i punës së F.S.SH.SH-së drejt të rinjve, për të ofruar dhe mobilizuar të rinjtë pranë strukturave të sindikatës tonë, që vetë ata-ato të jenë më të informuar rreth Sindikatave, rreth Federatës së Shëndetësisë, historisë së saj, strukturave, pluralizmit, profesionalizmit, aktiviteteve të kryera në vite, realizimeve konkrete, statutit dhe demokracisë së brendshme, partneritetit institucional, dhe gjithçkaje tjetër që mundëson njohjen më të mirë të të gjitha strukturave dhe vizionit të saj Instituconal.

-Në bashkëpunim me Sindikatën Italiane, C.I.S.L, Rajonin Iscos Markes, nëpërmjet bashkëpunimit me Projekte, Konfederata dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura, ka realizuar gjatë vitit të kaluar disa seminare trajnimi për të rinj, me tematika të cilat kanë kërkuar interes, ku prej Federatës së Shëndetësisë kanë qënë pjesëmarrës të rinj, anëtarë dhe jo anëtarë.

-Në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Friedrich Ebert, zyra Tiranë, ka organizuar, nën drejtimin e Dr. Erion Dobit, përgjegjës për të Rinjtë, pranë F.S.SH.SH-së dhe K.S.SH-së: Seminar kualifikimi/trajnimi, në TIRANË- Ditën e Shtunë, dt.20 Tetor 2007, ora 0930, me pjesëmarrjen e 3-5 individëve, të rinj, drejtues, të zgjedhur, të punësuar, nxënës, studentë, specializantë, kontribues të të gjitha Federatave të Profesioneve të ndryshme, (anëtare të K.S.SH-së).

-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, (F.S.SH.SH-ja), nisur nga nevoja dhe domosdoshmëria e rifreskimit të strukturave drejtuese dhe vendimmarrëse, si dhe rikonceptimit të politikave dhe vizionit të tyre, prej disa vitesh ka punuar konkretisht për të ofruar më shumë të rinj, (të punësuar, të papunë dhe nxënës e studentë të shkollave dhe Fakulteteve/Universiteteve të ndryshme), pranë sindikatës, me qëllim/me synim informimin e tyre, nxitjen, anëtarësimin, angazhimin dhe marrjen e përgjegjësiive konkrete prej tyre, duke ngritur edhe strukturat e Rinisë, bazuar në statutin, rezolutën dhe projektet, studimet përkatëse, aktivitete/investime këto që kanë rezultuar pozitive dhe me interes të ndërsjellë.

-Gjatë kësaj periudhe strukturat e Rinisë të Federatës dhe të Konfederatës, janë përfaqësuar në të gjitha takimet/konferencat e zhvilluara në Rajon dhe më gjërë, ku kanë trajtuar shqetësimet së bashku me kolegët e tjerë, Sindikatave të vendeve të tjera, si dhe kanë marrë përgjegjësitë konkrete.

-Gjatë viteve 2006-2007, Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë (F.S.SH.SH) ka hartuar një Projekt, me temë: Çfarë presin të rinjtë nga Sindikata?, projekt i cili u fitua dhe u Financua nga: Public

Services International (P.S.I) Shërbimet Publike Ndërkombëtare, F.O.A Danimarkë, kurse si studim u realizua nga: Instituti i Studimeve të Marrëdhënieve të Punës (I.S.M.P). Përfundimet u bënë të njohura gjatë organizimit të Konferencës së Dytë të Rinisë të F.S.SH.Shqipërisë, prej ku u morrën përgjegjësitë e strukturave përkatëse dhe u mirëcaktuan detyrat për të ardhmen. Gjatë realizimit të këtij projekti Informimi-kualifikimi u financuan për 2(dy) vjet 4300 Euro, ku 3800 Euro nga Financuesit dhe 500 Euro nga F.S.SH.SH-së. Projekti është udhëhequr nga Përfaqësuesi i Rinisë i F.S.SH.SHqipërisë, dr.Erion DOBI dhe nën kujdesin e Presidentit dr. Minella MANO. Projekti u realizua në Fakultetin e Infermierisë, Tiranën, Vlorë dhe Korçë.

-Ky projekt i ripunuar dhe i rikonceptuar, është rifituar/sponsorizuar nga P.S.I dhe FOA-Danimarkë edhe për vitet në vazhdim 2009-2010.

Gjatë realizimit të këtij projekti Informimi-kualifikimi do të financohen për 2(dy) vjet, 15.000 Euro, ku 13.000 Euro nga Financuesit dhe 2000 Euro nga F.S.SH.SH-së. Projekti do të realizohet në Fakultetin e Infermierisë, Tiranën, Vlorë, Korçë dhe tashmë shtohen Fakultetet e Qyteteve të Elbasanit dhe Shkodrës. Jemi në Fazën e përgatitjes të materialeve informuese dhe kualifikuese, ku më pas në fillim të Janarit 2009 do të fillojmë zbatimin konkret të tij në terren.

-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, në bashkëpunim me Federatën Greke të punonjësve të Spitaleve Publike, bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar midis tyre, mbas aplikimit fituan Projektin European Intereg III-A, Greqi-Shqipëri. Projekti synonte Kualifikimin e punonjësve sindikalistëve, të Spitaleve Publike të dy vendeve, i cili u zhvillua në Janinë-Greqi, prej dt, 13-23 Tetor 2008, ku nga Shqipëria morrën pjesë 40(dyzet) Mjekë/e dhe Infermierë/e, prej të cilëve 20(njëzet) ishin të rinj në moshë dhe si anëtare të Federatës së Shëndetësisë.

-Në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Friedrich Ebert, zyra Tiranë, ka organizuar me kërkesën dhe në bashkëpunim me F.S.SH.SH-së, Seminar kualifikimi/trajnimi, në Tiranë, në Berat, me pjesëmarrjen anëtareve, të drejtueseve të zgjedhura, të punësuar në sektorin e shërbimeve shëndetësore. Janë trajtuar tema si: Sindikatat dhe Roli i tyre, Statuti dhe Vendimmarrjet Demokratike, Kontratat Kolektive të Punës, Dialogu Social dhe të tjera leksione, bazuar në kërkesat dhe nevojat e kohës.

-Disa prej Seksioneve të Federatës, kanë menduar dhe investuar pak dhe shumë pak dhe nuk i janë përkushtuar kësaj detyre. Gjithsesi vlen të themi se, gjenden në fillim dhe se mund të quhet objektiv jo i kryer,

kjo edhe për pamjaftueshmëri angazhimi serioz nga njerëzit e përzgjedhur/e caktuar nga institucionet dhe strukturat përkatëse. Më pak nga Seksionet e Federatës është punuar për rininë/të rinjtë, ndonëse dihet që është kjo pjesë e shoqërisë ajo që gjendet në vështirësi të mëdha studimi, punësimi, edukimi, kualifikimi, integrimi dhe sigurimi të jetesës.

-Rrjeti i Gruas së F.S.SH.SH-së është krijuar nisur nga nevojat konkrete, nga detyrimet statutores dhe domosdoshmëria e pjesëmarrjes, e angazhimit të tyre, por edhe në vijim të rekomandimeve të P.S.I-së. Tashmë kjo strukturë është e ngritur dhe funksionon, por gjykoj se ka ende shumë punë për të realizuar që kjo strukturë të veprojë e pavarur dhe të marrë përgjegjësisë konkrete. Kjo strukturë për të ardhmen, duhet të synojë të rrisë kapacitetet dhe njohuritë profesionale, për të promovuar barazinë gjinore, për të luftuar diskriminimin, dhunimin, për të fituar të drejtat dhe të forcojë pozitën e grave-femrave, për të marrë pjesë në përgjegjësitë profesionale dhe ato sindikale.

-Përsa i përket punës me Gratë/me Femrat, është punuar më mire për edukimin e tyre, nisur edhe nga disa eksperiencë, projekte, (të realizuara në bashkëpunim dhe në bashkëfinancim me sindikata të tjera dhe me Institucione të ndryshme Ndërkombëtare, si: P.S.I, E.P.S.U, I.L.O, I.C.F.T.U, I.T.U.C, P.E.R.C, Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung (F.E.S), C.I.S.L-I.S.C.O.S, etj). dhe vendimmarrje, që vetë struktura e Federatës (dhe të Konfederatës) kanë ndërmarrë, por bazuar edhe në numrin e përgjithshëm që përbëjnë femrat në këtë profesion-shërbim (publik dhe privat), apo që gjenden të punësuar në ato vende/mjedise pune, ende ngelet shumë punë për të bërë.

-Ne si Federatë kemi vlerësuar zhvillimet tona dhe përgjithësisht të lëvizjes sindikale dhe bazuar në kërkesat e nevojat, kemi tërhequr mendimet dhe kërkesat, si dhe kemi realizuar studimet përkatëse, nëpërmjet disa projekteve, që kemi aplikuar (në P.S.I, në Fondacionin Friedrich Ebert Stiftung (F.E.S), etj, për të cilat presim përgjigjet.

-Puna me gratë/femrat dhe investimi për ofrimin, bashkëpunimin dhe kualifikimin e tyre, ngelet nevojë dhe domosdoshmëri, për strukturat tona profesionale dhe sindikale, prandaj po përgatitemi për të organizuar Konferencën e I-rë, të Grave të F.S.SH.SH-së, gjatë Muajit Prill 2008, për të cilën do të financohen-shpenzohen nga Federata rreth 240.000 mijë lek.

-Ka zhvillime pozitive nga Federata e Shëndetësisë, sikurse ngelet shumë për tu bërë nga seksionet dhe këshillat sindikale, në qarqe të ndryshme të vendit, ku shqetësimet, shkeljet e të drejtave, kërkesat dhe

diskriminimet janë të dukshme, dhe ku detyra e çdo sindikate është që të gjendet pranë tyre dhe të bëhet pjesë e mbrojtjes dhe e zgjidhjeve. Në mosrealizimin e këtij qëllimi/objektivi të rëndësishëm kanë ndikuar negativisht dhe pamjaftueshmërisht edhe të tjerë faktorë dhe aktorë, si brenda dhe midis Konfederatës/Federatave, ashtu edhe jashtë, pranë e përreth tyre.

Edukimi si Mbështetje për Zhvillim Sindikal Bashkëkohor

-Nevojat e edukimit, për kualifikime të gjera dhe të veçanta aktualisht janë të mëdha edhe për F.S.SH.SH-në dhe të gjitha strukturat që janë pjesë përbërëse të saj, e sidomos ato që janë më të reja në tregun sindikal, por edhe ato seksione, që për disa shkaqe dhe arsye, ndodhen sot në gjendje të vështira, përsa i përket aktiviteteve dhe nivelit profesional që ato ofrojnë ndaj anëtarëve dhe njerëzve të tjerë të interesuar. F.S.SH.SH-ja ka një eksperiencë të gjatë të edukimit sindikal dhe gjithmonë e ka konsideruar si një dimension kyç i veprimtarisë së saj.

-Gjatë viteve të kaluara u trajnuan në Shkollën Sindikale (sot LITUSA) shumë anëtarë të sindikatave të profesioneve dhe të niveleve të ndryshme të strukturave përfaqësuese, sikurse u kualifikuan disa ekipe trainerësh, të cilët do të bëheshin pjesë e rëndësishme e edukimit dhe kualifikimit sindikal. Ende ngelet domosdoshmëri trajnimi dhe kualifikimi, prandaj edhe nga Konfederata cilësohet si prioritetet/përparësitë që vlen dhe duhet të mirëpërcaktohen, dhe kjo duhet të bëhet të tilla që t'u korrespondojnë prioriteteve/përparësive të aprovuara, të miratuara nga vetë sindikatat, nga programi dhe politikat sindikale, sociale dhe juridike, me qëllim garantimin e strukturave demokratike të qëndrueshme dhe realizimin e një lëvizje të qartë sindikale, në interes të mbrojtjes të drejtave të anëtarëve dhe të zhvillimit shoqëror.

-Federata e Shëndetësisë, prej disa vitesh gjendet profesionalisht në tregun e studimeve, e cila nisur nga zhvillimet, gjatë kësaj periudhe të gjatë, ka realizuar një numër të konsiderueshëm studimesh dhe botimesh të nevojshme, të cilat zhvillojnë një aktivitet shkencor shumë ndihmues, jo vetëm për sindikatën, por edhe të tjerë njerëz apo grupime profesionale, të interesuara, duke ndikuar drejtpërdrejt në emancipimin e sindikalizmit, por edhe në zhvillimin e shoqërisë në tërësi.

-Janë disa projekte të rëndësishme që kjo Federatë po studion për ti zbatuar ato me efektivitet dhe me cilësi, duke ndihmuar çdo njeri apo

grupim të interesuar rreth tyre. Përmendim Siguria dhe Shëndeti në Punë, Dialogu Social, etj.

-Disa nga çështjet/tematikat e edukimit që do të trajtohen gjatë vitit 2009 nga F.S.SH.SH-ja: (ndonëse prej tyre disa janë trajtuar), të cilat vlen të konsiderohen si të rëndësishme dhe ndihmuese në procesin e trajnimit dhe të edukimit profesional janë:

- **Njohja, ratifikimi dhe zbatimi i konventave ndërkombëtare**
- **Legjislacioni i punës (i marrëdhënieve të punës)**
- **Pluralizmi sindikal, forcon strukturat dhe garanton pavarësinë**
- **Çështjet ekonomike (privatizimi, falimentimi, likuidimi)**
- **Papunësia, puna informale/ puna e zezë dhe punësimi,**
- **Të drejtat dhe dinjiteti në shoqëritë demokratike**
- **Ndërmarrjet shumëkombëshe, globalizimi**
- **Bisedimi, komunikimi dhe dialogu social,**
- **Kontratat kolektive dhe individuale të punës**
- **Lidershipi/ drejtuesi i sindikatës dhe lëvizjeve sindikale**
- **Informimi, organizimi dhe rekrutimi i anëtarëve të rinj**
- **Organizimi i punëtorëve në sektorin privat**
- **Kushtet e punës, siguria dhe mbrojtja e shëndetit në punë**
- **Barazia gjinore, konkurrimi dhe karriera profesionale**
- **Respektimi i statutit dhe demokratizimi i vendimmarrjeve**
- **Të drejtat e punonjësve të rinj**
- **Arsimimi, kualifikimi, edukimi dhe trainimi i trainerëve, etj.**

Përgatiti: dr. Minella Mano

President (F.S.SH.SH)

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë



Tiranë, më 26 Dhjetor 2008

Informacion mbi Rininë

-Struktura e Rinisë, ka adoptuar/përshtatur të njëjtën strukturë si Rrjeti i Gruas. Rrjeti i Rinisë mbështetet nga një Departament i Rinisë që ka buxhetin e tij. Objektivi kryesor është zgjerimi i audiencës së K.S.SH-së drejt të rinjve, dhe të mobilizojë të rinjtë sindikalistë që të jenë më aktivë në strukturat dhe aktivitetet e Federatave/Sindikatave të tyre profesionale, por edhe të K.S.SH-së.

-Rrjeti i Rinisë, tashmë ka më shumë eksperiencë, kjo e fituar nga aktivitetet brenda vendit gjatë realizimit të detyrës së tyre, por edhe në pjesëmarrjet (kongreset, konferencat, ballafaqimet, seminarët dhe trajnimet) e rëndësishme të drejtuesve dhe të tjerëve aktivistë, që janë realizuar jashtë vendit, si nga P.SI-ja, ashtu dhe nga strukturat dhe nivelet e tjera kontribuese dhe institucionale.

Të rinjtë kontribues, tashmë ndjehen pjesë kontribuese dhe vendimmarrëse e grupimit, sikurse marrin përgjegjësitë e tyre, duke kryer aktivitete konkrete, duke zbatuar projekte dhe duke manifestuar dhe protestuar mbi gjithçka që lidhet me interesat, me arsimimin, me profesionin, me punësimin, me jetën, me dinjitetin, të ardhmen e tyre dhe më gjerë me shoqërinë.

Gjatë kësaj periudhe:

-Në bashkëpunim me Sindikatën Italiane, C.I.S.L, Rajonin Iscos Markes, nëpërmjet bashkëpunimit me Projekte, Konfederata dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura, ka realizuar gjatë vitit të kaluar dhe në vazhdim, disa seminare trajnimi për të rinj, me tematika të cilat kanë kërkuar interes prej vetë strukturave dhe drejtuesve të tyre.

-Në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Friedrich Ebert, zyra Tiranë, ka organizuar, nën drejtimin e Dr. Erion Dobit, përgjegjës për të Rinjtë pranë K.S.Shqipërisë: Seminar kualifikimi/trajnimi, në TIRANË-Ditën e Shtunë, dt.20 Tetor 2007, ora 0930, me pjesëmarrjen e 3-5 individëve, të rinj, drejtues, të zgjedhur, të punësuar, nxënës, studentë, specializantë, kontribues të të gjitha Federatave të Profesioneve, anëtare të K.S.SH-së.

-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, (F.S.SH.SH-ja), nisur nga nevoja dhe domosdoshmëria e rifreskimit të strukturave drejtuese dhe vendimmarrëse, si dhe rikonceptimit të politikave dhe vizionit të tyre, prej disa vitesh ka punuar konkretisht për të ofruar më shumë të rinj, (të punësuar, të papunë dhe nxënës e studentë të shkollave dhe Fakulteteve/Universiteteve të ndryshme), pranë

sindikates, me qëllim/me synim informimin e tyre, nxitjen, anëtarësimin, angazhimin dhe marrjen e përgjegjësisë konkrete prej tyre, duke ngritur edhe strukturat e Rinisë, bazuar në statutin, rezolutën dhe projektet, studimet përkatëse, aktivitete/investime këto që kanë rezultuar pozitive dhe me interes të ndërsjellë.

-Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Shqipërisë, në bashkëpunim me Federatën Greke të Punonjësve të Spitaleve Publike, bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar midis tyre, mbas aplikimit fituan Projektin Europian Interreg III-A, Greqi-Shqipëri. Projekti synonte Kualifikimin e punonjësve sindikalistëve, të Spitaleve Publike të dy vendeve, i cili u zhvillua në Janinë-Greqi, prej dt, 13-23 Tetor 2008, ku nga Shqipëria morrën pjesë 40(dyzet) Mjekë/e dhe Infermierë/e, prej të cilëve 20(njëzet) ishin të rinj në moshë dhe si anëtare të Federatës së Shëndetësisë.

-Ka vendimmarrje, investime, nisma pozitive edhe nga Federata/Sindikata të tjera, që ndjejnë nevojën e afrimit të të rinjve pranë strukturave të tyre, por edhe që duhet të plotësojnë detyrimet e strukturave dhe të vetë reformimit profesional, sindikal dhe institucional, sikurse ka të tjera Federata/Sindikata, që nuk bëjnë detyrën dhe përpjekjet e tyre për të rinovuar drejtimin dhe anëtarësinë e strukturave të tyre, duke dëmtuar rëndë zhvillimin dhe garancinë e ecurisë të sindikatave.

Përgatiti
dr.Erion DOBI



Zv/President i F.S.SH.SH-së
Përgjegjës i Rinisë të F.S.SH.SH-së
Përgjegjës për të Rininë pranë K.S.Sh-së